UDHËZIM
Nr. 23, datë 1.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE MASAVE PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT TË TELEFONIT CELULAR DHE PAJISJEVE TË NDËRLIDHURA ME TË NË MJEDISET E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për ndalimin, përjashtimet, përgjegjësitë dhe masat në lidhje me përdorimin e telefonit celular dhe pajisjeve të ndërlidhura me të në institucionet arsimore parauniversitare.

2. Ky udhëzim mbështetet në parimet, studimet dhe rekomandimet kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhur me zhvillimin dhe mirëqenien e nxënësve në ambientet shkollore, dhe ndikimet e përdorimit nga nxënësit në shkolla të telefonave celularë dhe pajisjeve të ndërlidhura me telefonin, si më poshtë:

a) në parimet e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, që synon garantimin e një mjedisi të sigurt dhe të përshtatshëm për të gjithë nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies;

b) në përputhje me dispozitat ligjore, që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e nxënësve mbi përdorimin e mjeteve që mund të ndikojnë negativisht në procesin mësimor të kufizohen dhe të rregullohen me masa të posaçme sipas ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

c) në urdhrin nr. 31, datë 28.1.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

d) në Planin Kombëtar të Veprimit "Për fuqizimin e mekanizmave të parandalimit të çdo forme dhune e bullizmi për rritjen e sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare", miratuar me urdhrin nr. 32, datë 21.1.2025 e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

e) studimin e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) 2024 *"From decline to revival"*, i cili evidenton efektet negative të përdorimit të shpeshtë të telefonave celularë dhe rrjeteve sociale në rezultatet shkollore;

f) raportin e Organizata Botërore e Shëndetësisë (2024) *"A focus on adolescent social media use and gaming"*, i cili tregon rritjen e varësisë ndaj rrjeteve sociale dhe efektet e saj negative;

g) iniciativat e vendeve të ndryshme dhe rekomandimet e Këshillit të Arsimit të BE-së për miratimin e masave për ndalimin e përdorimit të telefonave celularë në shkolla për mbrojtjen e mirëqenies së nxënësve dhe përmirësimin e performancës shkollore.

3. Ky udhëzim ka për qëllim:

a) të sigurojë mjedise të qeta, të sigurta dhe të rrisë përqendrimin gjatë proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke synuar rritjen e rezultateve shkollore dhe arritjeve te nxënësit;

b) të parandalojë ndikimet negative, që vijnë nga përdorimi i pajisjeve elektronike gjatë orarit mësimor, duke ndikuar në sjelljen, në mirëqenien psikoemocionale të nxënësve dhe në cilësinë e procesit mësimor;

c) të stimulojë komunikimin efektiv dhe të evidentojë prirjet e nxënësve përmes shoqërizimit dhe interaktivitetit gjatë orëve mësimore, si dhe punës në grup duke rritur përqendrimin në proceset mësimore dhe edukative.

d) të promovojë edukimin për përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë, në kuadër të qytetarisë digjitale;

e) të forcojë rolin e shkollës si komunitet edukues në bashkëpunim me prindërit dhe komunitetin.

4. Rregullat dhe masat e përcaktuara në këtë udhëzim synojnë ruajtjen e një mjedisi mësimor cilësor, duke parandaluar shpërqendrimin dhe ndikimet negative, që lidhen me përdorimin e telefonit celular dhe pajisjeve të ndërlidhura me të, si:

a) ulja e përqendrimit gjatë mësimit;

b) dobësimi i kujtesës dhe aftësisë për të mbajtur mend informacionin e duhur lidhur me programin mësimor;

c) ulja e aftësisë për të analizuar dhe për të menduar në mënyrë kritike;

d) vështirësi në përshtatjen me situata të reja apo në zgjidhjen e problemeve;

e) dobësim i aftësive komunikuese dhe i ndërveprimit me të tjerët;

f) ulje e aktivizimit gjatë orarit mësimor;

g) nxitje e sjelljeve jo të përshtatshme dhe fenomeneve të dëmshme, të lidhura me dhunën dhe bullizmin, të cilat nxiten nga përdorimi jo i duhur i telefonave celularë apo pajisjeve të ndërlidhura me to, në mungesë të kontrollit prindëror.

KREU II
NDALIMI I PËRDORIMIT TË TELEFONAVE CELULARË DHE PAJISJEVE TË NDËRLIDHURA ME TELEFONIN

1. Ndalohet përdorimi i telefonit celular dhe pajisjeve të ndërlidhura me të nga nxënësit gjatë procesit mësimor dhe gjatë qëndrimit në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar.

2. Përdorimi i telefonit celular dhe pajisjeve të ndërlidhura me të gjatë orëve të mësimit është i ndaluar edhe për mësuesit, përveç rasteve emergjente, të përcaktuara në rregulloren e shkollës apo kur përdorimi lidhet drejtpërdrejt me nevoja të provuara pedagogjike ose organizative të procesit mësimor të lejuara nga drejtoria e shkollës.

3. Çdo pajisje e konstatuar apo përdorur në mënyrë të palejuar në ambientet e shkollës merret nga mësuesi dhe dorëzohet në drejtorinë e shkollës, deri në përfundim të orarit mësimor.

4. Përjashtimisht për nevoja urgjente nxënësit mund të komunikojnë me prindin apo personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, vetëm me lejen e mësuesit kujdestar/drejtorit të shkollës. Drejtuesit e shkollës janë në dispozicion për të mundësuar komunikimin e ndërsjellë të nxënësit me prindin në çdo rast emergjent të parashikuar në rregulloren e shkollës.

KREU III
PËRGJEGJËSITË E DREJTORISË SË SHKOLLËS

Drejtoria e institucionit arsimor parauniversitar (shkollës) ka për detyrë:

a) të sigurojë në çdo klasë një kuti/sirtar për depozitimin e telefonave celularë dhe pajisjeve të ndërlidhura me to, në rastet kur nxënësi i ka marrë ato në shkollë. Telefoni celular duhet të jetë i fikur ose në modalitetin *"Airplane"* dhe duhet të vendoset në kutinë e caktuar në klasë në nisje të procesit mësimor dhe deri në përfundim të tij;

b) personeli mësimor është përgjegjës për zbatimin e rregullit në klasë sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme të shkollës;

c) të përcaktojë në rregulloren e brendshme të shkollës, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesve të shkollës, mësuesve, oficerëve të sigurisë dhe shërbimit psikosocial, nxënësve, prindërve, të cilat lidhen me zbatimin e këtij udhëzimi;

d) të sigurojë që ky rregull t'i komunikohet të gjithë nxënësve dhe prindit/ve ose personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në fillim të vitit shkollor;

e) të organizojë takime me prindërit, për t'i informuar mbi rregullat dhe rëndësinë e zbatimit të tyre. Prindi duhet të konfirmojë që është njohur dhe e pranon këtë rregull;

f) të informojë sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të shkollës, prindin apo personin që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit, përmes fletores së komunikimit digjital në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), për ndalimin e përdorimit të telefonave celularë apo pajisjeve të ndërlidhura me to gjatë gjithë procesit mësimor;

g) të raportojë periodikisht për zbatimin e këtij udhëzimi në zyrën vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) për rezultatet e zbatimit të këtij udhëzimi dhe masat e marra.

KREU IV
ROLI DHE BASHKËPËRGJEGJËSIA E PRINDËRVE OSE E PERSONAVE QË USHTROJNË PËRGJEGJËSINË PRINDËRORE TË NXËNËSIT

1. Prindi apo personi që ushtron përgjegjësinë prindërore duhet të bashkëpunojë me shkollën për zbatimin e këtij udhëzimi, duke u angazhuar që nxënësi të mos marrë me vete apo të përdori telefonin celular apo pajisje të ndërlidhura me të, gjatë qëndrimit në shkollë.

2. Në rastin kur prindi ose personi që ushtron përgjegjësinë prindërore kërkon ta pajisë fëmijën me telefon celular në shkollë apo pajisje të ndërlidhura me të, duhet t'ia bëjë të ditur arsyen e pajisjes që në fillim të vitit shkollor drejtorisë së shkollës dhe duhet të angazhohet t'i bëjë të ditur fëmijës, se telefoni celular apo pajisja e ndërlidhur me të do të fiket apo vendoset ne modalitetin *"Airplane"* në kutinë/sirtarin e përcaktuar në klasë/shkollë dhe nuk do të përdoren për asnjë rast gjatë procesit mësimor, përveç rasteve të parashikuara në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës dhe të përcaktuara në rregulloren e brendshme të saj.

KREU V
PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE ARSIMORE VENDORE PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

ZVAP-të kanë detyrim:

a) të monitorojnë masat e marra nga institucionet arsimore parauniversitare për zbatimin e këtij udhëzimi;

b) të raportojnë një herë në vit në drejtorinë rajonale përkatëse të arsimit parauniversitar, e cila raporton në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar për zbatimin e këtij udhëzimi.

KREU VI
PROCEDURA NË RAST SHKELJEJE

1. Drejtoria e institucionit arsimor parauniversitar, në rast shkeljeje të këtij udhëzimi, është e detyruar të njoftojë menjëherë prindin apo personin që ushtron përgjegjësinë prindërore, përmes Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) dhe mjeteve të tjera të komunikimit shkollor.

2. Telefoni celular dhe pajisjet e ndërlidhura me të do t'i kthehen prindit apo personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit, pas orarit mësimor, në kohën kur prindi apo personi që ushtron përgjegjësinë prindërore paraqitet në shkollë dhe nxënësit i komunikohet me shkrim masa e marrë nga institucioni arsimor parauniversitar.

3. Përdorimi i telefonit celular dhe pajisjeve të ndërlidhura me të gjatë orëve të mësimit përbën shkelje të rregullores së shkollës dhe konsiderohet shkelje disiplinore që ndikon në vlerësimin për sjelljen.

KREU VII
MASAT NË RAST TË SHKELJEVE

1. Në rast të shkeljes për herë të parë të këtij rregulli nga nxënësi, masa e marrë do të jetë "këshillim" që shoqërohet me shënim nga mësuesi kujdestar, i cili njofton me shkrim prindin dhe nëpërmjet përdorimit të fletores digjitale në SMIP. Ky njoftim përfshin edhe marrjen dhe dorëzimin e telefonit celular apo pajisjeve të ndërlidhura me të në drejtori. Prindi, pas njoftimit, paraqitet në shkollë për marrjen e telefonit celular dhe/ose të pajisjeve të ndërlidhura me të.

2. Në rast të përsëritjes së kësaj sjelljeje nga nxënësi i arsimit bazë, konsiderohet shkelje e përsëritur dhe ndaj tij merren masat si më poshtë:

a) këshillim përmes Komisionit të Disiplinës së Shkollës në prani të nxënësit dhe prindit;

b) pjesëmarrje e nxënësit në orë/aktivitete të posaçme edukative dhe këshilluese apo në aktivitete komunitare që lidhen me edukimin qytetar dhe digjital në bashkëpunim me klubet e shkollës, për të cilat informohet dhe prindi.

3. Në rast të përsëritjes së shkeljes nga nxënësi i arsimit të mesëm të lartë, lidhur me ndalimin e përdorimit të telefonit celular apo pajisjeve të ndërlidhura me të, do të konsiderohet shkelje e përsëritur dhe ndaj tij, merren në mënyrë të përshkallëzuar masa disiplinore të përcaktuara në rregulloren e brendshme të shkollës

4. Institucionet arsimore parauniversitare, në funksion të zbatimit efikas të këtij udhëzimi, krahas masave të përcaktuara në këtë krye, mund të shtojnë në rregulloren e tyre të brendshme edhe masa të tjera për nxënësit, me karakter ndërgjegjësues, sensibilizues dhe edukues.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 34, datë 16.11.2018, "Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare", si dhe çdo akt tjetër mbi mospërdorimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare", shfuqizohet.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale e arsimit parauniversitar, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Orjana Osmani